REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KURBIN
KESHILLI BASHKIAK

Nr 1757 prot

Laç më 28/03 2023

VENDIM

Nr 23 Datë 24 / 03 /2023

"PËR MBARIM MANDATI KESHILLTARI PËRPARA AFATI".

Bazuar në pikën 1,2,3 dhe piken 4 germa b) të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore".Mandati i keshilltarit jepet me vendim këshilli.Dhënia dhe heqja e mandatit bëhen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të antareve të këshillit.Mandati i keshilltarit mbaron përpara afatit me dhënien e dorheqjes.Referuar dhe në deklaraten noterjale datë 23.02.2023 ku z.Edmod Piroli deklaron heqjen dore nga mandati i Anetarit së Këshillit Bashkiak si përfaqësues i partisë Bindja Demokratike me numer 1 në listën e fituesve të keshilltarëve të partise Bindja Demokratike Kurbin. Mbeshtetur në vendimin nr 79 datë 26.07.2019 nga Gjykata Apelit Tirane Kolegji Zgjedhor ku partia Bindja Demokratike Kurbin përfaqesohet në këshillë me 1 mandat.Me shqyrtimin e propozimin nga komisioni i mandateve, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI;

1. Miratimin e dorheqjes nga mandati i këshillit **z.Edmond Nikoll Piroli** përfaqësues i partisë Bindja Demokratike Kurbin me numer 1(një) në listën shumë emerore të Partisë Bindja Demokratike Kurbin në Keshillin Bashkiak.

.Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Këshilli Bashkiak.
.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

>Prefektit Të Qarkut Lezhë
>KQZ
>Arkivi

SEKRETARI I KESHILLIT
Arber LEKA

KRYETARE E KESHILLIT
Edlira LLESHI

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA KURBIN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1701/2 Prot.

Laç, më 28. 03 .2023

VENDIM

Nr. 21 datë 29/03/2023

"PËR DHËNIEN E NJË GJYSËM BURSE NJË NXËNËSI TË ARSIMIT BAZË PËR VITIN MËSIMOR 2022 – 2023"

Bazuar në ligjin Nr. 139/15, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 666 datë 10.10.2019, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike" të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 511, datë 27. 07. 2022 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike", shkresën Nr. 6478/54 Prot., datë 11.11.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit "Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2022-2023", 30 (tridhjetë) bursa, referuar shkresës Nr. 231 Prot., datë 17.03.2023, pika 2, të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kurbin "Për disa ndyshime në shkresën Nr. 1215 Prot. datë 16.12.2022 "Kërkesë për mbështetje financiare", për arsye largimi jashtë shtetit të nxënësit Alion Shkëlzen Hyseni, shkolla 9-vjeçare "28 Nëntori" Fushë Milot, i cili ka përfituar burse me vendimin nr.168 është menduar që fondi i kësaj burse të kalojë tek nxënësi Mikel Gjin Gjoka, shkolla 9-vjeçare "28 Nëntori" Fushë Milot, Pas propozimit nga ZVAP, Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Kryetari i Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI :

Të miratojë dhënien e një gjysëm burse, nxënësit Mikel Gjin Gjoka, shkolla 9-vjeçare "28 Nëntori" Fushë Milot .

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë

- **Prefektit të Qarkut Lezhë**
- **ZVAP Kurbin**
- **Drejtorisë së Arsimit Kulturës Rinisë dhe Sporteve**
- **Arkivit**

SEKRETAR I I KËSHILLIT

Arbër LEKA

KRYETARI I KËSHILLIT

Edlira LLESHI

Adresa: Lagjia Nr.3, Laç

E-mail bashkiakurbin@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1702/12 Prot.

Laç, më 28 . 03 .2023

VENDIM

Nr. 20 datë 24/ 03 /2023

"PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 168, DATË 21.12.2022 "MBI NDARJEN E BURSAVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT TË MESËM PARAUNIVERSITAR DHE ARSIMIT BAZË PËR VITIN MËSIMOR 2022 – 2023"

Bazuar në ligjin Nr. 139/15, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 666 datë 10.10.2019, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike" të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 511, datë 27. 07. 2022 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike", shkresën Nr.6478/54 Prot., datë 11.11.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit "Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2022-2023" 30 (tridhjetë) bursa, si dhe referuar shkresës Nr. 231 Prot., datë 17.03.2023, pika 2 të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kurbin "Për disa ndyshime në shkresën Nr. 1215 Prot. datë 16.12.2022 "Kërkesë për mbështetje financiare" për arsye largimi jashtë shtetit të nxënësit Alion Shkëlzen Hyseni, shkolla 9-vjeçare "28 Nëntori" Fushë Milot pas propozimit nga ZVAP drejtoria e arsimit bashkisë dhe Kryetaria e Bashkisë,Këshilli Bashkiak;

VENDOSI;

Të miratojë shfuqizimin e vendimit Nr. 168, datë 21.12.2022 "Mbi akordimin gjysëm burse të nxënësit Alion Shkëlzen Hyseni, shkolla 9-vjeçare "28 Nëntori" Fushë Milot.

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

>Prefektit Të Qarkut Lezhë.

>ZVAP Kurbin.

>Drejtoria e arsimit

>Arkivi

SEKRETARI I KESHILLIT

Arber LEKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KURBIN

KRYETARE E KESHILLIT

Edlira LLESHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

KESHILLI BASHKIAK

Nr. 1699/1 **Prot.** **Laç më** 28.03**2023**

VENDIM

Nr 19 **. Datë** 24 . 03 **.2023**

"MBI MARRJEN E STATUSIT TË TË PASTREHIT"

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore, në ligjin nr. 22/2018, date 03.05.2018 " Për Programet Sociale për Strehim" si dhe në V.K.M Nr. 574, date 29.08.2012 " Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t'u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore", pas propozimit nga Kryetaria e Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

VENDOSI;

Të miratojë listën e të pastrehëve të qytetarëve të mëposhtëm:

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Vendbanimi
1	Nertila	Ferit	Shafloqi	Laç
2	Gjok	Llesh	Gjegji	Laç
3	Edison	Ndue	Marku	Laç
4	Prene	Zef	Medha	Laç
5	Elis	Kol	Pasha	Laç
6	Dorina	Fran	Brunga	Laç
7	Pal	Nikoll	Paluka	Laç
8	Mirush	Haziz	Mirushaj	Mamurras

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

KESHILLI BASHKIAK

Nr 1700/ **Prot.** **Laç më** 28.03.**2023**

VENDIM

Nr 18 **. Datë** 24. 03.**2023**

"PËR MBËSHTETJE FINANCIARE NGA FONDI REZERVË"

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, " Për Vetëqeverisjen Vendore", në Ligjin Nr. 67, Datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin Nr.22, datë 03.05.2018 "Për Strehimin Social" dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 106, date 21.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023,pas propozimit nga Kryetarja e Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI;

1. Të miratohet ndihma financiare për akomodimin e familjeve për periudhen **1- vjeçare** të ambjenteve të marra me qira për familjet:

- Gjovalin Gjoka
- Tane Beqiri
- Llesh Çoba
- Asllan Mallkuqi

2. Të miratojë efektin financiar sipas tregut për banesat, në qytetin e Laçit :

- **Për banesa 1+1 : 12.400 x 15% (tatim burimi) = 14.260 lek në muaj**, *(171.120 lek në vit)*
- **Për banesa 2+1 : 15.600 x 15% (tatim burimi) = 17.940 lek në muaj,** *(215.280 lek në vit)*

3. Miratimin e kryerjes së shpenzimeve noteriale të mbulohen nga Bashkia Kurbin.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
KESHILLI BASHKIAK

Nr.1586/1 Prot

Laç , më 28/03/2023

VENDIM

Nr.17 Datë 24/03 /2023

" PER MIRATIMIN E TAVANEVE PERGATITORE TE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM VENDORE 2024 - 2026 TE BASHKISE KURBIN".

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 'Për vetëqeverisjen vendore',të ndryshuar ,nenit 37 të ligjit nr.68/2017 « Për Financat e vetëqeverisjes vendore »,ligjit Nr.9936.datë 26.06.2008 « Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise »të ndryshuar,ligjit nr. 10296.datë 08.07.2010 « Për menaxhimin financiar dhe kontrollin »,të ndryshuar,Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.23.datë 30.07.2018 « Për Procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV »,Udhëzimin Nr.6,datë 28.02.2023 « Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026 pas propozimit nga Kryetaria e Bashkisë,Këshilli Bashkiak ;

VENDOSI:

1. Të miratojë Tavanet Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 të Bashkisë Kurbin sipas tabelës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .
Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

>Prefektit Të Qarkut Lezhë
>Drejtoria e Financës
>Arkivi

SEKRETARI I KESHILLIT
Arber LEKA

KRYETARE E KESHILLIT
Edlira LLESHI